

EDUART CAKA

**ANALIZË E ASPEKTIT BURIMOR NË HISTORIOGRAFINË
SKËNDERBEGIANE SHQIPTARE
(ME PËRQENDRIM NË DOKUMENTACIONIN
DHE LITERATURËN OSMANE)***

Abstrakt

Figura e Skënderbeut zë një vend kryesor në historinë e Shqipërisë dhe të kombit shqiptar. Por, dimensionin e personalitetit të tij si në aspektin ushtarak ashtu edhe në atë politik e ka tejkaluar epokën kur ai jetoi dhe hapësirën gjeografike ku ai ushtroi aktivitetin e tij si udhëheqës. Ky aspekt dëshmohet nga veprat e shumta që i janë kushtuar figurës së tij përgjatë shekujve dhe nga shtrirja gjeografike e rrëfimeve, punimeve shkencore por edhe veprave artistike kushtuar personalitetit të Skënderbeut. Sigurisht që dendësia e studimit të figurës së tij është më e madhe në hapësirën shqiptare për faktin se Skënderbeu dhe epoka e tij kanë një rëndësi të veçantë në historinë shqiptare. Kështu në shek. XX, periudhë që përkon me konsolidimin e shtetit shqiptar dhe ngritjes së institucioneve kërkimore do të kemi një numër të konsiderueshëm studimesh mbi figurën e Skënderbeut.

Kjo kumtesë përqendrohet në analizën e aspektit burimor të studimeve skënderbegiane duke u fokusuar në gjysmën e dytë të shek. XX deri në ditët tona. Arsyeja e këtij periodizimi qëndron në faktin se pikërisht në këtë shekull, në Shqipëri zë fill edhe shkrimi i librave të historisë që mbështeten në parametrat dhe metodologjitë shkencore të historisë si disiplinë shkencore. Jashtë fokusit janë mbajtur edhe veprat dhe studimet e autorëve të huaj duke u përqendruar vetëm tek autorët shqiptarë. Qëllimi këtu është të bëhet i mundur një evidentim i hollësishëm i burimeve dhe arkivave të përdorur nga autorët shqiptarë mbi figurën e Skënderbeut por edhe i temave dhe fondeve që kanë mbetur jashtë këtij fokusi. Duke patur parasysh faktin se pjesa më e madhe

* Kumtesë e mbajtur në konferencën shkencore organizuar në kuadër të vitit mbarëkombëtar të Skënderbeut, Edicioni IX i Ditëve të Albanologjisë, organizuar nga Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë, më 3-5 dhjetor 2018.

literaturës dhe dokumentacionit të përdorur për figurën dhe epokën e Skënderbeut u përkasin arkivave perëndimore, ne do të përpiqemi të analizojmë dokumentacionin dhe literaturën osmane të përdorur në historiografinë skënderbegiane, me qëllim evidentimin e vlefshmërisë dhe kontributit të këtij dokumentacioni në zhvillimin e studimeve mbi figurën dhe epokën e Skënderbeut.

Hyrje

“Historia është e papërfunduar” shprehet Karl Jaspers teksa e trajton historinë si një proces morish ngjarjesh të cilat në vazhdimësinë e tyre mbartin në vetvete mundësi të panumërta përfundimesh.¹ Ndonëse në shumicën dërrmuese historianët nuk janë përfshirë në diskurin filozofik të historisë, fakti është se aspektin e sipërshënuar e hasin gjerësisht në studimet e tyre të përditshme. Klasifikimi i dokumentacionit arkivor, aplikimi i metodave dhe teorive të reja dhe qasja nga këndvështrime të ndryshme janë një tregues i qartë se studimi i një fenomeni, personazhi apo ngjarjeje historike nuk ka përfunduar. Këtë element e vërejmë edhe në rastin tonë ku, pavarësisht një numri tejet të madh të dorëshkrimeve, studimeve, dokumenteve e hulumtimeve të kryera mbi figurën e Gjergj Kastriotit, historiografia skënderbegiane vijon të pasurohet me qasje e studime të reja ndërkohë që orvatet të zbardhë anë të shumta të jetës dhe aktivitetit të tij që ka mbetur në errësirë.

Tanimë ekziston një korpus i madh studimesh mbi jetën dhe aktivitetin e Skënderbeut të trajtuar nga disiplina të ndryshme shkencore duke nisur nga letërsia e arti, për të vijuar tek biografite dhe punimet e karakterit studimor. Ndërsa në aspektin kohor, figura e tij ka qenë objekt shkrimi duke nisur qysh nga shek. XVI për të vijuar deri në ditët e sotme.² Sigurisht që studimi i të gjitha këtyre do ta tejkalonte qëllimin

¹ Karl Jaspers, *The Origin and Goal of History*, Yale University Press, New Haven: 1965, f. 272.

² Qysh në fillimin e shek. XVI hasim në tekste të shkruara mbi jetën dhe veprën e Skënderbeut. Brenda këtij korpusi të madh, fillimisht veçojmë veprën e humanistit Marin Barleti, e cila u përkthye në shumë gjuhë të huaja dhe u përdor vazhdimisht si burim kryesor në shekujt e mëvonshëm por edhe jetëshkrimet e Dhimitër Frangut, kujtimet e Gjon Muzakës dhe shumë të tjera. Për më shumë të dhëna shih: Aurel Plasari, *Skënderbeu: një histori politike*, Instituti Shqiptar i Studimeve “Gjergj Fishta”, Tiranë: 2010, f. 26-31.

dhe kufijte e kesaj kumtese. Per kete arsye, ne mbajtem si bosht te saj monografite dhe studimet e karakterit shkencor te shkruara nga historianet shqiptare mbi jeten dhe veprën e Skënderbeut.

Do te ishte jashte objektivit te kesaj kumtese gjithashtu te paraqesim edhe një bibliografi te studimeve qe kanë kryer kërkuesit shqiptare mbi Skënderbeun. Por, ajo çka vlen te theksojmë ka te bëjë me faktin se qysh në fillimet e ngritjes së institucioneve kërkimore shkencore në Shqipëri, figura e Skënderbeut ka qenë objekt artikujsh studimorë, konferencash dhe së fundi edhe monografish. Sigurisht qe kulmi i studimeve skënderbegiane do te arrinte me aktivitetet e organizuara me rastin e 500-vjetorit te vdekjes së tij, në vitin 1968 dhe, ato qe u mbajtën në vitin 2018 për 550-vjetorin e ndarjes nga jeta. Këtu përmendim veçanërisht botimet e Konferencës së Dytë Albanologjike³ apo veprën tre vëllimshme "Studime për epokën e Skënderbeut"⁴. Përveç këtyre qe cituam më sipër, epoka e Skënderbeut është trajtuar gjerësisht edhe në vëllimin e parë të "Historisë së Popullit Shqiptar", botim i cili pasqyron arritjet më të mëdha të historiografisë shqiptare për periudhën përkatëse.⁵ Sigurisht qe studimet skënderbegiane kanë kulmuar me punimet monografike të studiuesve shqiptarë si Frashëri⁶, Biçoku⁷ e Plasari.

Në këto vepra, studiuesit shqiptarë janë bazuar në një korpus të madh dorëshkrimesh, fondesh arkivore dhe veprash studimore duke u përpjekur të na japin një informacion të detajuar mbi jetën e Skënderbeut, karakterin e tij, shtetin qe drejtoi, marrëdhëniet me fisnikërinë shqiptare të kohës por edhe me fqinjët dhe fuqitë më të mëdha politiko-ushtarake të epokës së tij. Studimet në fjalë kanë arritur të hedhin dritë mbi shumë aspekte të jetës dhe veprës së Skënderbeut duke na paraqitur një panoramë të aktivitetit të tij politik dhe ushtarak. Sigurisht qe mbeten ende shumë elementë të pandriçuar si për vetë figurën e Skënderbeut, ashtu edhe në lidhje me këtë periudhë kaq të rëndësishme të historisë së

³ *Konferenca e dytë e studimeve Albanologjike (12-18 janar 1968)*, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë 1969.

⁴ *Studime për epokën e Skënderbeut*, vëll. I-III, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Tiranë 1989.

⁵ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. I, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2002.

⁶ Kristo Frashëri, *Skënderbeu: Jeta dhe vepra*, Botimet Toena, Tiranë 2002.

⁷ Kasem Biçoku, *Skënderbeu; dhe Shqipëria në kohën e tij*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë 2005; Kasem Biçoku, *Për Skënderbeun*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë 2005.

shqiptarëve, aspekte të cilat mbesin si sfidë për historiografinë skënderbegiane në të ardhmen.

Në një vështrim të përgjithshëm, vlen të theksojmë se pjesa më e madhe e punimeve të realizuara mbi jetën dhe veprën e Skënderbeut janë bazuar mbi burime dokumentare të marra nga arkivat e Venedikut, Raguzës, Vatikanit, Napolit por edhe të Spanjës dhe vendeve të tjera të Europës. Ndërkohë që si pozita gjeografiko-administrative e hapësirave shqiptare të shek. XV ashtu edhe vetë jeta dhe karriera ushtarako-politike e Skënderbeut deri në një periudhë të caktuar të tij që zhvilluar brenda një realiteti osman. Për pasojë, përdorimi i burimeve osmane në historiografinë shqiptare në përgjithësi dhe atë skënderbegiane në veçanti rezulton si një element i domosdoshëm. Parë nga ky këndvështrim, një analizë e aspektit burimor osman të përdorur në historiografinë skënderbegiane shqiptare jo vetëm që do të na jepte një pasqyrim të saktë të asaj çka burimet osmane i kanë shtuar studimeve mbi Skënderbeun, në të njëjtën kohë do t'i mundësonin studiuesit të bënte një bilanc të atyre që janë bërë dhe atyre që mbeten për t'u bërë në këtë drejtim, në mënyrë që kjo periudhë dhe vetë figura e Skënderbeut të zbardhet në të gjitha dimensionet e mundshme.

Analizë e aspektit burimor osman në historiografinë skënderbegiane shqiptare

S'ka histori pa burime, por as historian pa kritikë burimesh⁸ thekson Plasari në veprën e tij mbi Skënderbeun duke iu referuar Guy Thuillier dhe Jean Tulard. Në një vështrim të detajuar të studimeve mbi periudhën dhe figurën e Skënderbeut, ajo çka vërejmë lidhet me faktin se burimi dhe literatura osmane e përdorur në këto studime, në pjesën e saj dërrmuese karakterizohet nga përdorimi i kronikave osmane.⁹ Në këtë pikë, do të ishte me vend të trajtonim faktin se çfarë karakteri kanë këto vepra dhe, cili është raporti i vërtetësisë së të dhënave që japin ato? Si janë trajtuar kronikat në fjalë krahasuar me dokumentacionin arkivor

⁸ Plasari, *Skënderbeu*, f. 23.

⁹ Në pjesën dërrmuese, studiuesit që kanë trajtuar figurën e Skënderbeut në punimet e tyre, lidhur me përdorimin e kronikave osmane i referohen botimit të realizuar nga S. Pulaha. Shih. *Lufta shqiptaro-turke në shekullin XV (Burime osmane)*, përgatitur nga Selami Pulaha, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë: 1968.

osman për të studiuar hapësirën shqiptare të shek. XV në përgjithësi dhe hulumtimet skënderbegiane në veçanti? Përgjigjet e këtyre pyetjeve jo vetëm që do të na japin një panoramë të qartë të informacionit që studiuesi ka marrë prej këtyre veprave por, në të njëjtën kohë do të mund të evidentojë edhe gjendjen aktuale të historiografisë shqiptare të kësaj periudhe krahasuar me arritjet shkencore në këtë fushë në ditët tona.

Studiuesit turq dhe të huaj të cilët janë marrë me historiografinë osmane bashkohen në mendimin se të dhënat që jepen në kronikat e shek. XV-XVII duhet të përdoren përmes një filtri shkencor që nevojitet në këtë rast.¹⁰ Ndër shkaqet e kësaj përmendim jo vetëm sigurinë dhe vërtetësinë e të dhënave që kanë këto kronika por, edhe karakterin subjektiv –në pjesën më të madhe të rasteve- të personave që i përpiluan këto vepra. Sigurisht që këtu nuk kemi për qëllim mohimin apo zhvlerësimin e këtyre burimeve me rëndësi për kohën kur u shkruan dhe ngjarjet për të cilat rrëfejnë. Por, fakti është se një pjesë e mirë e hartuesve të kronikave osmane u përpiluan nga persona të cilët ishin afër me drejtuesit osmanë ose kishin qenë nëpunës të këtij shteti.¹¹ Madje, lartësimi i ushtrisë dhe sulltanit të tyre dhe, poshtërimi e ulja e armikut për ta thujse ishte një detyrë hyjnore.¹²

Përveç faktit se armiku përballë i përkiste një besimi e bote tjetër dhe si pasojë ai duhej ulur e poshtëruar, ishte edhe interesi personal ai që i shtynte kronikanët osmanë të tregoheshin të njëanshëm në veprat që shkruanin. Në këtë rast ata do të shpërbleheshin apo promovoheshin në poste të ndryshme. Një shembull në këtë rast është edhe kronikani i

¹⁰ Duhet theksuar se në mesin e historianëve të periudhës osmane ka patur debate të shumta në lidhje me kronikat e hershme osmane dhe informacionet që ato përçojnë, diskutime në të cilat janë përfshirë emra të njohur si Colin Imber, Halil Inalcik apo edhe Irene Beldiceanu. Madje, sipas Imber pjesa më e madhe e kronikave të shkruara deri në vitet 1500 janë trillime. Shih. Colin Imber, “Osmanlı Hanedanı Efsanesi”, çev. Seyfettin Erşahin, *İslami Araştırmalar Dergisi*, v. 12, nr. 1, Ankara 1999, f. 17-24. Teza të tilla kaq në ekstrem kanë gjetur kundërshtimin e historianëve të shumtë por pjesa më e madhe e studiuesve të këtyre kronikave bashkohen në faktin se të dhënat e tyre duhen mbështetur edhe me dokumentacionin arkivor.

¹¹ Suraiya Faroqhi, Fikret Adanır, “Introduction”, *The Ottomans and the Balkans; A Discussion of Historiography*, ed. Fikret Adanır and Suraiya Faroqhi, Brill, Leiden: 2002, f. 7.

¹² Feridun M. Emecen, “Osmanlı Tarihinin Başlangıcı: İlk Manzum Tarihler”, *Türk Tarihinin Asırlık Çınarı Halil İnalcık’a Armağan*, ed. Mehmet Öz- Serhat Küçük, Türk Kültürünü Araştırma Enstitüsü Yayınları, Ankara 2017, f. 115; Gjithashtu shih. Plasari, *Skënderbeu*, f. 171.

njohur i shek. XV Ashikpashazade. Vetë ai kishte marrë pjesë në fushatat ushtarake osmane në zonat e Rumelisë.¹³ Vetë ai e kishte shkruar veprën në kohën kur ishte në pension por, siç thekson edhe Faroqhi, Ashikpashazade nuk i kishte lënë pas ende ambiciet e tij për poste.¹⁴ Siç duket, këto janë edhe shkaqet që tek vepra e tij kritikant janë thujse të padukshme, e sidomos për sulltanët.¹⁵

Megjithëse edhe studiuesit shqiptarë e vënë në dukje karakterin subjektiv të kronikave osmane¹⁶, sërish në veprat e tyre burimet në fjalë janë përdorur në shumicë krahasuar me burimet e tjera arkivore. Ndërkohë që duke nisur nga gjysma e parë e shek. XX kishte nisur botimi i regjistrave kadastrorë osmanë të cilat mund të cilësohen si burimet më të rëndësishme osmane dhe, deri diku të vetmet për shek. XV. Për fatin tonë të mirë, regjistrat më të hershëm osmanë i përkasin hapësirës shqiptare¹⁷, element i cili e bën më të lehtë për historianin shqiptar studimin e shek. XV. Një pjesë e këtyre regjistrave u përkthyen në gjuhën shqipe gjatë viteve 60 prej orientalistëve shumë të aftë si Mykerem Janina, Vexhi Buharaja dhe historianëve si Selami Pulaha. Megjithatë këto burime kaq të rëndësishme do të mbeteshin “të burgosura” nëpër arkiva deri në ditët e sotme duke mos u përdorur siç duhet për studimin e shek. XV në përgjithësi dhe punimeve skënderbegiane në veçanti. Përkthimi i defterëve në fjalë, është treguesi i parë, ndoshta dhe i fundit se historiografia shqiptare që në të njëjtin nivel me ato të vendeve të tjera të Ballkanit.¹⁸

¹³ Suraiya Faroqhi, *Approaching Ottoman History; An Introduction to the Sources*, Cambridge University Press, Cambridge 1999, f. 148.

¹⁴ Faroqhi, *Approaching Ottoman History*, f. 148.

¹⁵ Sipas Faroqhi vetë Ashikpashazade nuk merret me kritika të drejtpërdrejta ndaj sulltanëve por tek ndihmësit apo vartësit e tyre. Si shembull ajo jep trajtimin që Ashikpashazadeja i bën figurës së Rum Mehmed Pashës, grek nga origjina dhe sadrazam i Mehmetit II. Kështu, veziri në fjalë tenton të sabotojë punën e tij si shenjë hakmarrjeje ndaj marrjes së Kostandinopojës prej osmanëve. Për më shumë shih. Faroqhi, *Approaching Ottoman History*, f. 148.

¹⁶ Plasari, *Skënderbeu*, f. 371.

¹⁷ Bëhet fjalë për defterët kadastrorë të sanxhakut të Arvanidit dhe atë të zonave të Përmetit dhe Korçës, regjistra që datojnë në vitin 1431.

¹⁸ Për shembull, Akademia e Shkencave e Bullgarisë në vitin 1966 ka përgatitur dhe botuar disa defterë që i përkasin shek. XV dhe që gjendeshin në Bibliotekën Kombëtare të Sofjes. Për më shumë shih. Halil İnalçık, Evgeni Radoshev, Uğur Altuğ, *1455 Tarihi Paşa Livası İcmal Defteri*, Türk Tarih Kurumu Yay., Ankara 2013, f. XVII.

Shfrytëzimi i defterëve në fjalë, nuk mbart vetëm të dhëna të thata që kufizohen vetëm me emrat e timarlinjve, fshatrave, kryefamiljarëve apo të ardhurave që vlej nga hapësirat shqiptare të marra nën regjistrim gjatë shek. XV. Por, një punim i hollësishëm studimor mbi këto burime dokumentare do të sillte përfundime tejet të rëndësishme për historinë e shqiptarëve të këtij shekulli. Punime të tilla janë me rëndësi edhe për të kuptuar gjendjen ekonomike të hapësirës shqiptare gjatë kësaj periudhe, prodhimet që vileshin dhe kultivoheshin në këtë gjeografi por, edhe dëmet që pësuan fshatrat e qytetet shqiptare nga luftërat e zhvilluara në këto zona. Defterët në fjalë mbartin gjithashtu rëndësi edhe për aspektin etnik dhe demografik të hapësirave që janë marrë nën regjistrim. Për shembull, do të duhej studimi i bizantinologut Johannes Koder në vitin 2017 për të paraqitur një tezë rreth aspektit demografik të hapësirës që zinte sanxhaku i Arvanidit në vitet 30' të shek. XV¹⁹, ndërkohë që studiuesi shqiptar këtë vepër e kishte të përkthyer në duar që para 70 vitesh.

Po ashtu, mjafton të vërehet defteri i përmbledhur i zonave të Përlepit dhe Kërçovës të vitit 1445 për të kuptuar rezonancën e shtrirjes dhe jehonës së lëvizjes së Skënderbeut ku dy djemtë e dizdarit të kalasë së Koxhaxhikut, e braktisin timarin e tyre për t'u bashkuar me Gjergj Kastriotin.²⁰ Historiani është më objektiv kur studion listën e fshatrave të rrënuara apo të shkatërruara që kalojnë në defterët kadastrorë osmanë se kur citon kronistët osmanë të cilët gjithë krenari mburren mbi “ngadhënjimet ndaj të pafeve në vendin e arnavudit”. Ndonëse në shumicën e rasteve zyrtarit osman që ishte përgjegjës për regjistrimin e një hapësire administrative nuk ia dimë origjinën, përpiluesi i defterëve në fjalë i përkiste asaj gjeografie ku kryhej regjistrimi²¹, element që është tepër i rëndësishëm për toponiminë e hapësirës shqiptare të kësaj periudhe. Kjo gjë vlen edhe për emrat e njerëzve ku debati nëse emri i Gjon Kastriotit ishte Giovanni, Iohannes, Juvan e Ivan gjen zgjidhje në

¹⁹ Johannes Koder, “Defter-i Sancak-i Arvanid si burim të dhënash demografike mbi Epirin në kapërcyellin prej sundimit bizantin në atë osman (me dy harta dhe gjashtë tabela)”, *Studime Historike*, nr. 1-2, Tiranë: 2017, f. 41-60.

²⁰ Feridun Emecen, “Defter-i Köhne: Pırlepe-Kırçova Kesiminin En Eski Timar Defteri (1445-1445)”, *Osmanlı Araştırmaları*, XLIII (2014), f. 341-474.

²¹ *Regjistri i sanxhakut të Arvanidit i vitit 1431*, përgatitur për botim në turqisht nga Halil Inalcik, përkthyer nga Mykerem Janina, Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë 2017, f. XIX.

regjistrin e sanxhakut të Arvanidit ku tokat e Gjon Kastriotit janë shënuar si “Juvan-ili”, pra Juvan.²² Në këtë kontekst, burimet osmane na tregojnë se emri i tij është shënuar si Juvan, emër që i referohet përkatësisë së tij ortodokse të kishës serbe.²³ Po ashtu, regjistri i zonave të Dibrës i vitit 1467 tregon se osmanët i ishin afruar Krujës qëkur Skënderbeu ishte akoma në jetë.²⁴ Në këtë kontekst, studimi i burimeve dokumentare osmane përveç aspektit ekonomikohistorik i shërben studiuesit të kësaj periudhë edhe për të hedhur dritë mbi aspekte të ndryshme të historisë sociale, demografisë, historisë së qyteteve etj.

Nisur nga çfarë u parashtrua më sipër, mendimi ynë është se në historiografinë skënderbegiane burimet osmane janë përdorur në mënyrë sipërfaqësore, në rastin më të mirë të pjesshme. Shkaqet e kësaj, në mendimin tonë janë të karakterit metodologjik dhe ideologjik. Një pjesë e konsiderueshme e studiuesve që merren me periudhën apo tematikën në fjalë nuk e njohin gjuhën osmane e atë turke, element që ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në qasjen ndaj burimeve arkivore. Kjo të çon në mosnjohjen e etapave, problemeve dhe koncepteve të veçanta që ka historia e Perandorisë Osmane në tërësinë e saj. Për më tepër, përdorimi i dokumenteve të përkthyer me cungime në periudhën e mëparshme e çon studiuesin në përfundime të gabuara.²⁵ Qasja kritike e munguar, paraqitja e dokumenteve pa citime, tendenca për të shkruar drejt faktit pa krijuar një sistem mendimi apo trajtim analitik janë problematika të rëndësishme me të cilat përballet historiografia skënderbegiane në veçanti, e ajo shqiptare në përgjithësi.

Një element tjetër që ka ndikuar dhe ndikon në përdorimin e burimeve osmane ka të bëjë me aspektin ideologjik ku për shumë studiues mbizotëron tendenca e trajtimit të Perandorisë Osmane, siç e

²² *Regjistri i sanxhakut të Arvanidit*, f. 196.

²³ Në hyrjen e gjatë që i bën defterit të sanxhakut të Arvanidit, Inalcik thekson se në praktikën osmane përpiluesit e defterëve ishin njerëz që i përkisnin gjeografisë në fjalë apo që e njihnin gjuhën e vendit i cili merrej në regjistrim. Më konkretisht, për shkruerit e regjistrin në fjalë, ai thekson se e njehtë në mënyrë shumë të mirë gjuhën shqipe. Shih. *Regjistri i sanxhakut të Arvanidit*, f. X.

²⁴ Defteri në fjalë është përpiluar në gjysmën e parë të vitit 1467. Ndër zonat e marra në këtë regjistrim bëjnë pjesë edhe kala të rëndësishme si ajo e Koxhaxhikut, Stelushit e Petralbës por edhe fshatra të nahijes së Matit e cila kufizohej me kryeqendrën e Skënderbeut, Krujën.

²⁵ Dritan Egro, *Historia dhe ideologjia: Një qasje kritike studimeve osmane në historiografinë moderne shqiptare*, Maluka, Tiranë 2007, f. 117.

thekson Egro, duke iu referuar Todorovës, si një faktor frenues të dorës së parë.²⁶ Mirëpo, kjo nuk do të thotë se përdorimi i dokumentacionit arkivor osman është diçka që frenon edhe zhvillimin historiografik shqiptar. Përkundrazi, historia e shqiptarëve do të merrte dimensione shumë herë më të mëdha nëse do të përdoreshin burimet osmane.

Përfundim

Historiografia skënderbegiane ka ardhur duke u plotësuar vazhdimisht duke plotësuar dhe zbardhur elementët e panjohur të kësaj periudhe, vetë figurës së Skënderbeut dhe realitetit politiko-shoqëro-ekonomik të hapësirës shqiptare gjatë kësaj periudhe. Këto arritje kanë prekur kulmin pas viteve 2000 me publikimin e disa monografive prej studiuesve shqiptarë mbi figurën e Skënderbeut. Por, zbulimi i dokumenteve e bën të papërfundueshëm procesin e historishkrimit, element që tregon se për sa kohë të ekzistojë zbulimi i dokumenteve dhe fakteve të reja, figura dhe vepra e Skënderbeut do të mbetet në fokusin e punës së studiuesve të tij. Parë nga ky këndvështrim, përdorimi i pamjaftueshëm i të dhënave që përmbajnë arkivat osmane deri më sot nga studiuesit shqiptarë e bën të nevojshëm një rikthim dhe përqendrim më të madh në arkivat turke. Në përfundim të këtij procesi, mendojmë se historiografia skënderbegiane do të ketë përfutur të dhëna tepër të rëndësishme mbi figurën e Skënderbeut por edhe mbi historinë e shqiptarëve gjatë kohës kur ai jetoi.

²⁶ D. Egro, *Historia dhe ideologjia* ..., f. 106.

